



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.291/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se postereve në afërsi se qendrës se votimit 100 m, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.291/2017 e datës 12.06.2017, me të cilin është pretenduar se kandidatja për deputete Beatrisa Pista- Demiri, nga **Koalicioni PDK-AAK-NISMA**, ka vazhduar me vendosjen e posterave në afërsi të qendrës se votimit, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidatja për deputete Beatrisa Pista- Demiri, nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka vazhduar vendosja e posterav në afërsi të qendrës se vendvotimit në afërsi prej 15 m , edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-CD, së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së,
gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë te qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim te nenit 117 par.3 të LZP-së, për te

provuar pretendimet ankimore. Sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është shkolla fillore “Isa Boletini” dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për te votuar si Qendër e Votimit, në ditën e votimit

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Anr.291 /2017 më datën 13.06.2017

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.



Kyesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi